



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 464/5 Prot.

Tiranë, më 12 .10 . 2015

V E N D I M

Nr. 111 , datë 12 .10 .2015

**Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 464/1, datë 16.07.2015**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e verifikimit të kryer në Institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik për rastin e nëpunëses

***** ,

VËREJ SE,

Në zbatim të Urdhrit nr. 464/1 prot., datë 16.07.2015, është nisur verifikimi i ligjshmërisë së procedurës në lidhje me formularin e vlerësimit "Jo Kenaqshëm(4)", Vendimit nr.1170/3 prot datë 26.06.2015 për moskonfirmimin e statusit, si edhe të vendimit të lirimt nga shërbimi civil nr. 1174 prot datë 26.06.2015, të punonjësës ***** .

Nga shqyrtimi i akteve të sjella më shkresën nr. 464 prot, datë 30.06.2015 prej kërkueses ***** , si edhe nga praktika dokumentare marë gjatë inspektimit, në Institucionin e Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se ***** ka filluar punë në datë 12.11.2013, me akt emërimi, në pozicionin inspektore pranë Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave, në Komisionin e Prokurimit Publik. Fillimi i efekteve të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, e ka gjetur në punë në këtë pozicion dhe meqë nuk kishte mbushur një vit nga koha e fillimit të punës, në bazë të pikës 4 të nenit 67 të ligjit në fjalë, ajo është deklaruar nëpunëse civile në periudhë prove, e cila (periudha e provës) fillonte ditën e fillimit të efekteve të ligjit.

Në datë 08.05.2015, bazuar në ligjin nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”* i ndryshuar, neni 57 dhe 58/a; ligjin nr.9131, datë 08.09.2003 *“Për rregullat e etikës në administratën publike”*, neni 3; VKM nr.115, datë 05.03.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen dhe vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*; VKM nr.184 datë 17.03.2010 *“Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*, i ndryshuar, neni 2/1, si dhe të rregullores së brendshme të Komisionit të Prokurimit Publik, Drejtoresha e Drejtorisë të Shqyrtimit të Ankesave, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me cilësinë e eprorit direkt, ka njoftuar fillimin e procedimit disiplinor ndaj ***** , Inspektore në Drejtorinë e Shqyrtimit të Ankesave.

Në datën 25.05.2015, pas përfundimit të procesit të verifikimit dhe vlerësimit të rrethanave të çështjes për punonjësen në fjalë, nga ana e eprorit direkt ***** , Drejtore e Drejtorisë të Shqyrtimit të Ankesave, bazuar në nenin 58/a dhe 59 pika 1, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, është vendosur marrja e masës disiplinore *“Vërejtje”*, me motivacionin *“Për shkelje të etikës ndaj nëpunësve të institucionit”*.

Në datën 26.06.2015, rezulton se eprorja direkte, ka përpiluar një vlerësim të pjesshëm mbi punën e punonjës ***** , që përfshinte periudhën 04.dhjetor 2014 deri 26. Qershor 2015, duke arritur në përfundimin se puna e saj vlerësohej në nivelin *“Jo kënaqshëm”* (njoftimi i vlerësimit është bërë me shkresën nr. 1170 dt. 26.06.2015). Nga përmbajtja e njoftimit dhe e formularit të vlerësimit, rezulton se eprorja direkt ka arritur në këtë përfundim për shkak se punonjësja e vlerësuar nuk ka realizuar objektivat dhe nuk ka përmbushur pritshmëritë lidhur me qëndrimin dhe sjelljen profesionale; kthimin në shumë raste të produkteve të punës së saj, për shkak të pasaktësive në të dhëna; mos komunikimit të mirë me kolegët; mungesën e rritjes të performancës pas trajnimeve, etj.

Po në datën 26.06.2015, me Vendimin Nr.1170/3 prot., eprori direkt ***** , ka vendosur *“Moskonfirmimin e punonjës ***** në përfundim të periudhës së provës”*, për arsyet e mësipërme.

Në bazë të aktit në fjalë, po në këtë datë, me Vendimin Nr.1174 prot., drejtuesi i institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik, në zbatim të gërmës c) të pikës3 të nenit 24, gërmës ë) të nenit 66 të ligjit nr.152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe pikave 42,45,46,dhe 51 të Kreut VII, të Vendimit nr.171, datë 26.03.2014 të Këshillit të Ministrave *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, ka vendosur *“Lirimin nga shërbimi civil”* të ***** Inspektore në Drejtorinë e Shqyrtimit të Ankesave, pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

Por, veç sa sipër, rezulton gjithashtu se, kërkuesja ***** ndaj veprimeve administrative të Komisionit të Prokurimit Publik ka paraqitur 3 (tre)kërkesë padi pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, nëpërmjet të cilës ka kërkuar:

1. *Kundërshtimin e aktit administrativ “Formularit të vlerësimit të punës” të datës 26.05.2015, bërjen e rivlerësimit të punës, marrjen e masës së sigurimit të padisë etj.*
2. *Shfuqizimin e Vendimit të datës 25.05.2015, për “Marrjen e masës disiplinore vërejtje” Shfuqizimin e Vendimit Nr.1170/3 të datës 26.06.2015 të Drejtorit të Drejtorisë së Shqyrtimit të Ankesave, Shfuqizimin e Urdhrit Nr.1174 të datës 26.06.2015 “Mbi lirin e nëpunësit civil”, të Kryetarit të KPP-së, Detyrimin e palës së paditur për të më rikthyer*

në vëndin e mëparshëm të punës, detyrimin për të më paguar pagën e plotë deri në momentin e ekzekutimit të këtij vendimi.

3. *Konstatimin e pavlefshmërisë së “Formularit të vlerësimit të punës” të datës 26.05.2015, bërjen e rivlerësimit të punës .*

Aktualisht, rezultojnë se këto çështje, janë duke u shqyrtuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.

Në kushtet kur neni 36 i Kodit të Procedurës Civile, sanksionon parimin themelor të mos shqyrtimit nga institucionet e tjera, të çështjeve që po trajtohen apo janë trajtuar nga sistemi gjyqësor, vlerësoj se në këtë rast, nuk është e nevojshme për t’u investuar apo për të ndërhyrë nga ana e Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe nenin 16 dhe 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar me Urdhrin e verifikimit nr. 464/1 prot., datë 16.07.2015, “Për verifikimin e informacinit të nëpunëses ***** , në lidhje me formularin e vlerësimit “Jo Kenaqshëm(4)”, Vendimit nr.1170/3 prot datë 26.06.2015 për moskonfirmimin e statusit të nëpunësit civil, si edhe të Vendimit të lirit nga shërbimi civil nr. 1174 prot datë 26.06.2015, nga Komisioni i Prokurimit Publik”
2. Të njoftohen për këtë vendim, Kryetari i Komisionit të Prokurimit Publik si dhe kërkuesja, ***** .
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëher.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA